

SYLLABUS - Vlerësimi në Edukimin nga Kimia

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Edukimit Master i Mësimdhënies në Kimi
Titulli i lëndës:	Vlerësimi në Edukimin nga Kimia
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti i dytë, Sem. III
Numri i orëve në javë:	2+0 (2 orë)
Vlera në kredi – ECTS:	5 ECTS
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Asoc.Dr.Arlinda Bytyqi – Damoni
Detajet kontaktuese:	arlinda.damoni@uni-pr.edu ;
Përshkrimi i lëndës	Kursi do të fokusohet në shqyrtimin e vlerësimit shikuar nga këndi i shkencës së kimisë, këndin etik dhe psikologjik, ndërlidhjen e vlerësimit me të nxënit nga kimia, llojet e vlerësimit në shkencën e kimisë, si vlerësimin laboratorik, vlerësimin e projekteve të ndryshme nga kimi. Ky kurs, rëndësi te veçante do ti kushtojë vlerësimit me qëllim mësimnxënien, vlerësimin e vazhdueshëm në klasë, vlerësimin përmbledhës, zbatimin e vlerësimeve të standardizuara kombëtare dhe vlerësimet ndërkombëtare, si TIMSS (Trendet në Studimin Ndërkombëtar të Materimatikës dhe Shkencës) dhe PISA (Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Studentëve), vlerësimin e programeve, vlerësimin përmes portofolios, vlerësimin e punimeve të shkruara, etj. Kursi gjithashtu trajton edhe aspektet e ndryshme të standardeve të arsimit në nivele dhe kontekste të ndryshme (në nivel vendi dhe ndërkombëtar) duke përfshirë edhe procesin e caktimit të standardeve në arsim.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi parësor i kursit është përgatitja e studentëve për integrimin e vlerësimit në mësimdhënie dhe për studim 'kritik' të çështjeve që lidhen me vlerësimin në përgjithësi.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none"> • diskutojnë rolin e vlerësimit në procesin e mësimdhënies dhe në arsim, • analizojnë nocionet dhe teoritë e ndryshme lidhur me vlerësimin, • diskutojnë ngjashmëritë dhe specifikat në mes kontrollimit dhe vlerësimit si dhe ndërlidhjen midis tyre, • zbatojnë mënyra të përshtatshme të vlerësimit në praktikën e tyre profesionale dhe të reflektojnë rreth tyre me qëllim të përmirësimit të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, • përshkruajnë llojet e vlerësimeve në arsim, ndërlidhjen e tyre me praktikën profesionale, zhvillimin e arsimit në përgjithësi dhe institucioneve të arsimit parauniversitar në veçanti, • analizojnë standardet vendore dhe ndërkombëtare në arsim. • analizojnë literaturë mbi vlerësimin

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike	-	-	-
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10
Ushtrime në teren			
Kollokfiume, seminare	3	2	6
Detyra të shtëpisë	2	10	20
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	2	10	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)			
Projektet, prezentimet ,etj	3	2	6
Totali			123 orë
123: 25 ≈ 5 ECTS.			
Metodologjia e mësimdhënies:	Metodologjia e mësimdhënies që do të zbatohet në këtë kurs do të jetë kryesisht interaktive dhe e orientuar drejt involvimit të studentëve në diskutime. Rëndësi e veçante i kushtohet aspekteve praktike të shtjellimit të temave konkrete ku studentët do të angazhohen në detyra praktike në lidhje me temat përkatëse. Prezantimet e mësimdhënësit do të shërbejnë si pikënisje dhe formulim i kornizës brenda së cilës do të orientohet puna e studentëve.		
Metodat e vlerësimit:	<p>Vlerësimi në këtë kurs zbaton qasjen e vlerësimit të vazhdueshëm. Vlerësimi në këtë kurs synon jo vetëm të verifikojë aftësitë dhe arritjet e studentit të caktuar por edhe bashkëpunimin e tyre brenda grupit dhe ngritjen e përgjegjësisë për të kontribuar në zhvillimin e kolegëve brenda grupit.</p> <p>Vlerësimi mbështetet në këto aktivitete:</p> <p>Detyrat e shtëpisë 25 % (5 detyra ne total)</p> <p>Pjesëmarrja dhe diskutimi ne klasë 5 % (Pjesëmarrja do të përfshijë pjesëmarrjen në diskutimet në lidhje me leximin kritik dhe të menduarit për mësimdhënien e kimisë)</p> <p>Reflektimet javore.....20 % (Portfolio - për secilën njësi mësimore (artikull), të dorëzohet reflektimi para realizimit të asaj njësisë mësimore)</p> <p>Prezantim i planifikimit te mësimit me vlerësimin formativ në kimi 10% (grupore) (prezantim në klasë i një njësie mësimore duke përdorur strategjitë e vlerësimit formativ gjate mësimdhënies dhe të nxënit e kimisë dhe diskutimi rreth problemeve të mësimdhënies nga kimia në SHMU dhe SHML. Prezantimi i burimeve te nevojshme për mësimdhënësin dhe nxënësin për te realizuar njësinë mësimore)</p> <p>Provimi përfundimtar.....40 % (Provimi përfundimtar përmban pyetje dhe detyra nga temat e diskutura gjatë semestrit dhe leximi i materialeve të sugjeruara gjatë</p>		

	<p style="text-align: center;">semestrit)</p> <p>Të gjitha obligimet (reflektimet dhe detyrat) të dërgohen përmes emailit. Dokumentet të ruhen si në shembujt më poshtë: Reflektimi 1. Filan Fisteku, VEK Detyra 1. Filan Fisteku (GRUPI), VEK Puna në grupe do të menaxhohet në atë mënyrë që kontributi i secilit anëtarë të grupit do të duhet të dëshmohet me rastin e dorëzimit të detyrës.</p> <p style="text-align: center;">Pikët (%) Nota</p> <table style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <tr><td>94 -100</td><td>10</td></tr> <tr><td>84 - 93</td><td>9</td></tr> <tr><td>73 - 83</td><td>8</td></tr> <tr><td>61 - 72</td><td>7</td></tr> <tr><td>50 - 60</td><td>6</td></tr> </table> <p>Referenca dhe stili i shkrimit Studentët inkurajohen të përdorin stilin akademik gjatë hartimit të detyrave të kursit dhe në rast të shfrytëzimit të burimeve të tjera duhet t'i binden rregullave të APA-s.</p>		94 -100	10	84 - 93	9	73 - 83	8	61 - 72	7	50 - 60	6
94 -100	10											
84 - 93	9											
73 - 83	8											
61 - 72	7											
50 - 60	6											
Literatura												
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> Një numer artikujsh shkencor mbi vlerësimin Zucker, S. (2003). Fundamentals of standardized testing. San Antonio, TX: Pearson. Clarke.Sh. (2008). Active learning through Formative Assessment. Hodder Education. Corcoran, T., Mosher, F. A., & Rogat, A. (2009). Learning progressions in science: An evidence-based approach to reform. New York: Consortium for Policy Research in Education: Teachers College. 											
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> <i>Kurrikulat Bërthamë 2 dhe 3</i> <i>Standardet e vlerësimit</i> 											
Plani i dizajnuar i mësim:												
Java	Ligjërata që do të zhvillohet	Detyrat										
Java e parë:	Paraqitja e kursit. Syllabusi dhe detyrat											
Java e dytë:	Aspekte të përgjithshme të vlerësimit, vlerësimi në KKK, Udhëzimi administrativ (MASHT) për vlerësimin e nxënësve sipas Kornizës së Kurikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës. Artikulli 1. Examining Principles of Formative and Summative Feedback											
Java e tretë:	Artikulli 2. The Characteristics of Formative Assessment in Science Education											
Java e katërt:	Artikulli 3. Technology Enhanced Formative Assessment for 21st Century Learning	Detyra 1. Analize kritike e rishikimit të literaturës për një temë (nga mësimdhënia e kimisë) të përzgjedhur nga studenti.										

		Te citohen se paku 6 – 10 punime shkencore) Detyra 1 lidhet me detyrën 2 dhe 3.
Java e pestë:	Artikulli 4. Formative Assessment and the Contemporary Classroom: Synergies and tensions between research and practice	
Java e gjashtë:	Artikulli 5. Preparing Teachers to Make the Formative Assessment Process Integral to Science Teaching and Learning	
Java e shtatë:	Artikulli 6. Peer Assessment of Elementary Science Teaching Skills	
Java e tetë:	Artikulli 7. Assessing Student Learning through Guided Inquiry: A case study of Beginning Teachers	Detyra 2. Formulimi i problemit dhe qëllimit të hulumtimit (detyra lidhet me detyrën 1 dhe 3)
Java e nëntë:	Artikulli 8. Engaging Students through Formative Assessment in Science	
Java e dhjetë:	Artikulli 9. Assessment of Critical – Analysis Thinking	
Java e njëmbëdhjetë:	Artikulli 10. Self-Assessment and Assessment for/as Learning	
Java e dymbëdhjetë:	Artikulli 11,a. Assessment for Learning; Artikulli 11,b. Formative Assessment	Detyra 3. Planifikimi i Propozimit të Hulumtimit (detyra lidhet me detyrën 1 dhe 2)
Java e trembëdhjetë:	Prezantimi I, Artikulli 12. Performance Assessment	Detyra 4. Planifikimi i mësimimit me vlerësimin formativ në kimi
Java e katërbëdhjetë:	Prezantimi II, Artikulli 13. Including Often-Missed Knowledge and Skills in Science Assessments	
Java e pesëmbëdhjetë:	Provimi final	Detyra 5. Filozofia ime e vlerësimit në lenden e kimit

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

- Përcjellë ligjëratat dhe të kryejnë të gjitha detyrat e përshkruar në syllabus. Të gjitha punët, por edhe pjesëmarrja në ligjëratat janë pjesë e vlerësimit përfundimtar.
- Jetë i/e lirë të bëjnë pyetje dhe të marrin pjesë në çdo aktivitetet.
- Lexoj literaturën e kërkuar dhe artikujt e sugjeruar, të marrë pjesë në diskutimet në klasë, të përgatitet për të gjitha aktivitetet tjera.
- Përgatitë dhe dorëzon të gjitha detyrat në kohën e duhur. Çdo vonesë do të ndëshkohet me pikë të humbura.
- Përdorë stilin APA në të gjitha detyrat e shkruara (shih shembuj në Doracakun për shkrimin e tezës së Masterit).
- Në provimin përfundimtar kanë të drejt të paraqiten vetëm studentët që kanë marrë pjesë në ligjëratat

dhe ushtrime dhe që kanë kryer detyrat gjatë kursit.

- Studentët kanë të drejtë të hyjnë në provimin përfundimtar më së shumti tri herë (Neni 115 i Statutit të UP-së).
- Gjatë orëve mësimore dhe provimeve nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë.
- Nuk lejohet ardhja me vonesë apo largimi nga ora pa arsye.
- Nuk lejohet KOPJIMI dhe cilado formë tjetër e mashtrimit gjatë provimeve.

Planifikimi i mësimit me vlerësimin formativ

Titulli i mësimit: _____

Qëllimet e të nxënit: _____

Kriteret e suksesit: _____

Përvojat e të nxënit Merrni parasysh: <ul style="list-style-type: none"> - Konceptet thelbore të të nxënit - Pikat kyçe të mësimit - Rezultatet (kompetencat) ne shkence 	Struktura e pjesëmarrjes				Çfarë të dhënash mbledhim? Merrni parasysh: <ul style="list-style-type: none"> - Detyrat - Vëzhgimet - Pyetjet - diskutimet 	Vlerësimi i ndërsjellët	Vetëvlerësimi
	Puna me gjithë grupin	Puna në grupe të vogla	Puna në dyshe	Puna Individuale			

Pikat kyçe të mësimit	
Niveli i parnjohurive	Si do të mbështeten nxënësit?
Përgjigjet (zgjidhjet) e pritura	Si do të mbështeten nxënësit?
Përgjigjet (zgjidhjet) sfiduese	Si do të mbështeten nxënësit?
Z	

Rubrika për raportin e shqyrtimit të artikullit javor

Faqja 1	Titulli i artikullit, informata për revisten Emri dhe mbiemri, data	1 pikë
Faqja 2	Shkruani një përmbledhje të artikullit	3 pikë
Faqja 3		
1.	Të paraqitet problemi dhe rëndësia, qëllimi i studimit, pyetja/et dhe/ ose hipoteza/t (2-3 paragrafe)	2 pikë
2.	Shqyrtimi i literaturës (1-2 paragrafë) <ul style="list-style-type: none">• A janë burimet e cituara të lidhura me studimin?• A është shqyrtimi shumë i gjerë apo shumë i ngushtë?• A janë referencat e kohës së fundit?	1 pikë
3.	Dizajnimi dhe procedurat (3 - 4 paragrafë) <ul style="list-style-type: none">• Cila metodologji e hulumtimit është përdorur?• Cilat mjete matëse janë përdorur?• Si janë strukturuar procedurat?• Cilat janë variablet?	2 pikë
4.	Analiza dhe paraqitja e të dhënave (1-2 paragrafe) <ul style="list-style-type: none">• Si u analizuan të dhënat?• A ishin të dhënat cilësore apo sasiore?• A mbështesin të dhënat hipotezën dhe qëllimin?• A u diskutuan dobësitë dhe problemet?	1 pikë
5.	5. Përfundimet dhe implikimet (2-3 paragrafë) A janë përfundimet e studimit të lidhura me qëllimin e studimit A janë diskutuar implikimet? Te kush do të ndikojnë rezultatet dhe konkluzionet? Cilat rekomandime janë bërë në përfundim?	2 pikë
	Vlerësimi i përgjithshëm (1 paragraf) Cila është vlerësimi juaj i përgjithshëm i studimit dhe artikullit ?	3 pikë

Gjithsej 15